VENDIM
Nr. 580, datë 17.7.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1061, DATË 8.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 10 032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1061, datë 8.7.2010 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 1 që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikat e rritjes së pagave për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	**Grada**	**Paga bazë për gradë**	**Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi**		
			Në funksion të Policisë të Regjimeve të Jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe grupet e ruajtjes së objekteve në D.P.Burgjeve	Në funksion të Policisë të Regjimeve të Brendshme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe grupet e transferim- shoqërimit në IEVP dhe në D.P.Burgjeve	Në funksion të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Bazë	Nëninspektor	37500	4000	8000	
	Inspektor	41000	4000	8000	
	Kryeinspektor	46000	4000	8000	2000
				8000	
I Mesëm	Nënkomisar	56000	4000	8000	2000
	Komisar	60500	4000	8000	2000
	Kryekomisar	83000	4000	8000	2000
I lartë	Drejtues	95000			6500
	Drejtues I	99000			10000